

PAVIFLOOR

FINITURË EPOKSIDE BIKOMPONENTE BAZË UJI, VOC I ULËT, PËR DYSHEME ÇIMENTO DHE QERAMIKE

Seri 876

PËRSHKRIMI

Finiturë me spesor të ulët, ideale për lyerjen e dyshemeve në çimento dhe sipërfaqeve qeramike të magazinave, fabrikave dhe ambienteve që kërkojnë fortësi të lartë sipërfaqësore, rezistencë ndaj gërryerjes dhe ferkimit të peshave të kamionëve. Formulimi me përbërje të ulët të komponentëve organikë të paqëndrueshëm (VOC), që nuk kanë plastifikues, lejon zëvendësimin e shpejtë në ambientet e lyera. Rezistencë e lartë ndaj detergjentëve dhe higjienizuesve, vajrave dhe yndyrnave.

Konform me kërkesat e Reg. CE 852/2004 në higjienën e produkteve ushqimore

ISTRUKSIONE PËR PËRDORIM

E aplikueshme në:

- Sipërfaqe çimentoje të reja ose të lyera.
- Suva gëlqereje dhe çimento.
- Sipërfaqe qeramike horizontale dhe vertikale.

KARAKTERISTIKAT TEKNIKE

PAVIFLOOR është produkt bi-komponent.

- Komponenti A: rezinë epokside në solucion ujqor.
- Komponenti B: katalit në solucion ujqor.
- Solventi: ujë
- Dendësia UNI EN ISO 2811-1:
Komponenti A, i bardhë =1,40±0,05 kg/l.
Komponenti A transparent=1,27±0,05 kg/l.
Komponenti B=1,05±0,05 kg/l.
- Shkëlqimi EN ISO 2813: 55±5 këndi I leximit 60°, gjysëm-shkëlqim.
- Jetëgjatësia: 2 orë në 20 °C.
- Tharja (në 25 °C dhe 65% U.R.): prekja pas 4 orësh; shtresa tjetër pas 24 orësh dhe jo më vonë se pas 48 orësh.
- Klasifikimi Cilësia e Ajrit të Brendshëm (Indoor Air Quality): A+
- Konform me HACCP sipas kërkesave të Reg. CE 852/2004.

PËRGATITJA E SIPËRFAQES

DysHEME në çimento:

- Sigurohuni që sipërfaqja të jetë e tharë mirë dhe tërësisht e maturuar.
- Kontrolloni gjendjen e konsolidimit. Sipërfaqja duhet të jetë e qëndrueshme dhe nuk duhet të tentojë të shkërmoqet/plasaritet. Në të kundërt, sigurohuni konsolidim me produkte specifike.

- Niveloni parregullsitë e sipërfaqes. Çarjet, plasaritjet, dhe vrimat mund të trajtohen me produkte me bazë çimento.
- Kontrolloni gjendjen e bojës së mëparshme. Pjesët që nuk janë të aderuara mirë, duhet të largohen.
- Hiqni, me zmerilim ose me ujë me presion mesatar, mykun prezent dhe të tjera. Në sipërfaqe të pastra dhe të thara aplikoni një shtresë astar epoksid CONTINUO LINK, seri 116, sipas udhëzimeve të përshkruara në skedën teknike.
- Vazhdoni me aplikimin e PAVIFLOOR sipas udhëzimeve të përshkruara.

Sipërfaqe suva:

- Sigurohuni që sipërfaqja të ketë një kohë maturimi prej të paktën 28 ditësh.
- Kontrolloni gjendjen e sipërfaqes. Sipërfaqja duhet të jetë e qëndrueshme. Në të kundërt, sigurohuni konsolidim me produkte specifike.
- Hiqni, me zmerilim ose me ujë me presion mesatar, ndotjet e pranishme.
- Në prani të bojrave të vjetra, hiqni pjesët e ciflosura dhe jo të mirë aderuara, ndërsa pjesët e ngritura të bojës në gëlqere ose temperave, duhet të hiqen komplet, duke e larë sipërfaqen me ujë të bollshëm dhe duke e fërkuar ose duke përdorur makineri zmerelimi, pastrimi.
- Niveloni parregullsitë e sipërfaqes. Çarjet, plasaritjet, dhe vrimat mund të trajtohen me BETOMARC 9450150 ose RASAMIX 9440160 ose me produkte me bazë çimento.
- Zmeriloni çarjet e stukuara me letër zmerile
- Hiqni smogun, pluhurat dhe çdo ndotje tjetër me zmerilim.
- Në prani të mykut, trajtoni sipërfaqen me detergjentin COMBAT 222 kod. 4810222 dhe me detergjentin COMBAT 333 kod. 4810333 (I cili penetron në brendësi/thellësi të sipërfaqes).
- Në sipërfaqe të thatë vazhdoni me aplikimin e PAVIFLOOR sipas udhëzimeve të përshkruara.

Sipërfaqe qeramike:

- Realizoni një pastrim të mirëfilltë me ujë dhe detergjentë për të eliminuar elementët që mund të komprometojnë/pengojnë aderimin.
- Në sipërfaqe të thatë vazhdoni me aplikimin e PAVIFLOOR sipas udhëzimeve të përshkruara.

UDHËZIME PËR APLIKIM

- Kushtet e ambientit dhe të sipërfaqes:
Temperatura e ambientit: Min. +8 °C / Max. +35 °C

PAVIFLOOR

FINITURË EPOKSIDE BIKOMPONENTE BAZË UJI, VOC I ULËT, PËR DYSHEME ÇIMENTO DHE QERAMIKE

Seri 876

Lagështira relative e ambientit: <75%
Temperatura e sipërfaqes: Min. +5 °C / Max. +35 °C

Lagështira e sipërfaqes: <10%
- Kohët e tharjes dhe punueshmërisë influencohen shumë nga temperatura: në temperatura të ulëta kohët zgjaten, ndërsa në temperatura të larta shkurtohen.
-Shkalla e mbulimit: 8-10 m²/l për shtresë dhe l referohet sipërfaqeve lisho dhe mesatarisht absorbuese. Eshtë mirë të përcaktohet konsumi me një provë paraprake në sipërfaqe specifike.

Mënyra e aplikimit:

Mjetet: pinel, rrul.

Shtresat: 2 shtresa.

Raporti i katalizës në volum: 1,6 pjesë nga komponenti A + 1 pjesë nga komponenti B Holloni me ujë përzierjen e përfuar (A+B) në masën 20% për shtresën e parë, 10% për shtresën e dytë.

Shembull shtresa e parë: (2,5 L komponent A + 1,5 L komponent B) shtoni 0,8 L ujë.

Shembull shtresa e dytë: (2,5 L komponent A + 1,5 L komponent B) shtoni 0,4 L ujë.

-Mos shtoni më shumë ujë për të zgjatur jetëgjatësinë.

-Përzierja (katalizoni) dhe përdorni një paketim për një herë (komp. A + komp. B).

-Respektoni me përpikmëri raportet e përzierjes.

-Për të shmangur formimin e hijeve, aplikoni produktin në vazhdimësi, duke shmangur kalimin e rrulit ose pinelit në sipërfaqjen e ljer kur produkti fillon të ngjisë/aderohet.

- Mjetet duhet të pastrohen menjëherë pas përdorimit me ujë

-Produkti mund të mbivendoset me vetveten.

-Respektoni kohët e tharjes para kalimit të shtresës tjetër.

-Rezistencat kimike dhe mekanike arrihen pas 7 ditësh nga aplikimi.

NGJYROSJA

Komponenti A është i disponueshëm në versionin e bardhë (0019) dhe bazë transparente (0062), të dy të ngjyrueshëm me Sistemin Tintometrik.

MAGAZINIMI

Temperatura maksimale e ruajtjes: +30° C

Temperatura minimale e ruajtjes: +5 ° C

Produkti preferohet të përdoret brenda 2 vitesh nga data e prodhimit, nëse është ruajtur në ambalazh origjinal të pahapur dhe në kushte temperature të përshtatshme.

UDHËZIME SIGURIMI

Vlera limite BE (Dir. 2004/42/EC)

Cat. A/j: bojë bi-komponente me performancë të lartë (bazë uji): 140 g/l (2010)

Produkti përmban max: 30 g/l VOC

Shkakton irrim të lëkurës. Shkakton irrim të rënda okulare. Mund të shkaktojë reaksion alergjik të lëkurës.

Produkti duhet të transportohet, përdoret dhe stokohet/magazinohet sipas normave aktuale të higjienës dhe sigurisë; pas përdorimit mos l hidhni mbetjet në ambient l lini të thahen dhe l trajtoni ato si mbetje të vecanta. Për më shumë informacion konsultohuni me skedën e sigurisë.

SPECIFIKIMET

Finiturë epokside bi-komponente bazë uji me VOC të ulët, për dysHEME në çimento dhe qeramike.

Aplikimi, në sipërfaqje të predispozuar për finiturë epokside, bi-komponente, bazë uji, PAVIFLOOR seri 876, në të paktën 2 shtresa, me një konsum minimal prej 220 ml/m².

Furnizimi dhe instalimi i materialit € për m².

SAN MARCO GROUP garanton që informacionet e kësaj skede janë marrë nga eksperiencia e saj dhe nga njohjet e saj teknike dhe shkencore; megjithatë nuk mund të mbajë asnjë përgjegjësi për rezultatet e arritura duke qenë se kushtet e aplikimit janë jashtë kontrollit të saj. Këshillohet të verifikohet gjithmonë efikasiteti i produktit. Skeda e paraqitur anulon dhe zëvendëson çdo skedë të mëparshme. Për informacione të mëtejshme teknike kontaktoni në nr.pa pagesë të Asistencës Teknike 800853048.